

WUS Austria, serish nis garën sfiduese

27/01/2010 13:48:00



Studentët pjesëmarrës në finalen e Vjenës do ta kenë rastin të marrin pjesë në “Dita e Panairit të Punës” që do të mbahet në muajin korrik

Arbër Salihu

Universiteti i Vjenës dhe Agjencioni Austriak i Kooperimit WUS-Austria do ta mbajë këtë vit gjysmëfinalen e programit ‘Rasti Sfidues i Kosovës’ (Kosova Case Challenge) ku do të përfaqësohet tek Rasti Sfidues i Ballkanit (Balkan Case Challenge) që do të mbahet në Vjenë. Kjo është një garë e rastit studimor si dhe një ngjarje e rekrutimit për studentët e shkëlqyer të Arsimit të Lartë të Kosovës.

Rasti Sfidues i Kosovës, organizohet për të gjashtë herë me radhë. Aplikimi ka filluar nga 15 janari dhe zgjatë deri më 1 mars të këtij viti, ndërsa gara do të mbahet me 7, 8 dhe 9 maj në Prishtinë, kurse finalja e Vjenës do të mbahet nga 5 deri me 10 Korrik.

Ky është njëri nga 5 projektet që po i zhvillon WUS-Austria në Arsimin e Lartë në Kosovë. Katër master programe të reja, janë duke u zhvilluar në Universitetin e Prishtinës të cilat ndihmohen nga kjo qendër, ku si partner kanë universitetet e Austrisë. But Dedaj, menaxher rajonal i WUS-Austria, tha se programi përbëhet nga tre pjesë, trajnimin për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara, ku fituesit nga çdo disiplinë do të zgjidhen për më tutje drejt Vjenës dhe ngjarja e rekrutimit. “Kjo është një garë për rastet e caktuara që studentët i marrin ku i aplikojnë dijet e tyre teorike në rastet praktike dhe duhet t’i japin zgjidhje”, tha ai. Synimet e këtij projekti sipas Dedaj, është që studentët dijet e tyre teorike t’i zhvillojnë në praktikë. Në të njëjtën kohë edhe kompanitë të ofrohen me studentët, shtoi Dedaj.

E njëjta garë zhvillohet edhe në vendet tjera të Evropës Juglindore ku nga përzgjedhja që do të bëhet, rrugën e sfidimit për në Vjenë do ta marrin 150 studentë nga 11 shtete të tjera të Evropës Juglindore dhe Austria.

Sipas koordinatores së projektit, Luljeta Aliu gara do të zhvillohet në Prishtinë dhe 50 studentë do të kenë mundësi garimi në fushat përkatëse. “Një ndër trajnimet është përmirësimi i aftësive të prezantimit, mënyra e përgatitjes së CV-së. “Studentët do të

marrin trajnimin edhe në rastet konkrete që ata do të simulojnë dhe do t'i zgjidhin rastet konkrete”, sqaroi Aliu. Në përfundim do të mbahet edhe gara e rekrutimit. Me këtë rast kompanitë do të mund t'i ndjekin studentët dhe njëkohësisht t'i përzgjedhin studentët më të mirë të garës, ata të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në Vjenë, tha Aliu.

”Ky është një rasti ku studentët garues mund ti prezentojnë vlerat e tyre dhe t'u krijohet një mundësi punësimi në kompanitë pjesëmarrëse” tha ajo.

Nga tradita e mbajtjes së këtij programi studentët tanë kanë treguar suksese të larta përkrahë studentëve tjerë garues nga Evropa Juglindore. Bud Dedaj potencoi se rreth 50% të çmimeve të ndara vitin e kaluar i kanë takuar studentëve nga Kosova.